

DISA ASPEKTE FILOZOFIKE TË VLERËSIMIT SHKAKËSOR PËR SJELLJEN E VULLNETSHME DHE TË PAVULLNETSHME

Dr. Adriana ANXHAKU

Abstrakt: *Koncepti i përgjegjesisë në të drejtën është i lidhur pazgjidhshmërisht me kërkesën për të përligjur në mënyrë shkakësore disa sjellje e veprime si të vullnetshme ose jo. Duke marrë shkas nga disa teza të H.L.A. Hart, ky punim synon të vejë në dukje ato probleme që mund të lindin nga përdorimi i shkakësisë në përligjen e veprimeve kundër normave ligjore. Pyetjet më esenciale që ngrihen këtu e të cilave synon t'u përgjigjet punimi, pa i shteruar natyrisht, janë:*

-Sa mund të quhet “shkak” për veprimin një motiv ose veprim paraardhës në kohë?

-Sa i lirë mund të jetë personi për të bërë zgjedhjen e tij në “zinxhirin e shkaqeve dhe pasojave”?

-Çfarë roli luan rastësia dhe kur mund të quhet se kemi të bëjmë me rastësi?

-A mund të konsiderohet lidhje shkak pasojë një rend i përsëritur veprimesh që ndjekin njëri-tjetrin disa herë?

Nga një rreshtim argumentesh, del se lidhja ndërmjet një pikënisje fillestare të një veprimi dhe pasojat e tij të kundërligjshme mund të jetë e padrejtë. Këtu, pra synohet të paraqiten disa kritere filozofike të së drejtës për të vlerësuar e dalluar një sjellje të vullnetshme nga ajo e pavullnetshme, në mënyrë që të peshohet barra e përgjegjesisë.

Fjalët çelës: *Shkakësia, sjellja e vullnetshme, përligjja, përgjegjësia, pasojat.*

Të jesh përgjegjës, në kuptimin e së drejtës dhe moralit, do të thotë të marrësh përsipër me vullnet një veprim ose mosveprim të pritshëm prej rolit shoqëror që ke. Shumë prej paqartësive në këtë fushë vijnë, prejse nuk mund të përcaktohet qartë shtrirja e veprimit dhe se sa qëllim ka pasur brenda tij. Prandaj në marrjen e vendimeve gjyqësore, jo vetëm sigurimi i informacionit sa më të mirë të mundshëm, por dhe interpretimi i tij luajnë një rol të madh në përcaktimin e përgjegjësive. Në këtë kërkim për shkaqet e veprimit ndërthuren intuita, arsyeja, përvoja, përkimi i mundësive etj. Për rrjedhojë, hedhja dritë mbi disa raporte konceptuale e reale në këtë fushë, mund t'i ndihmojë procesit të të kuptuarit në këtë drejtim.

1. Shkakësia dhe përgjegjësia

Për të mbërritur në një vlerësim të saktë të shkaqeve e përgjegjësive, disa filozofë të së drejtës si Alexy (Robert), mendojnë se, “ rregullat e argumentimit që vlejné për

racionalitetin në përgjithësi mund të zbatohen edhe në fushën e së drejtës.”¹ Mirëpo, logjika e ligjit nuk është e njëjtë ndonjëherë me rregullat logjike të arsyes së pastër, pikërisht se i nënshtrohen imponimit të zbatimit kur miratohen. Në këtë mënyrë njerëzit janë të detyruar ta zbatojnë ligjin, edhe kur u duket i mangët e në kundërshtim me arsyen. Koncepti shkakësisë, që përdoret rëndom për të zbuluar përgjegjësinë, gjendet si në shkencat e natyrës, ashtu dhe në shkencat humane si ajo e së drejtës. E meqë, në këto fusha nuk ka një skemë fikse shkakësore, vetëkuptohet se pse në teoritë e së drejtës nuk gjenden rregulla të prera se kur vendimi për përgjegjësinë është i drejtë.

Megjithatë, duhet thënë se lidhja shkak-pasojë në natyrë ndryshon nga lidhja shkak-pasojë në shoqërinë njerëzore, sepse tek e para pasojat rrjedhin më së shumti pa ndërhyrjen e njeriut, kurse në shoqëri kudo ndikon me veprimin e tij njeriu. Ja pse, qysh prej skolastikës është dalluar “causa cognosendi” që vjen prej njohjes së një sendi nga njeriu, nga “causa essendi” që vjen prej qenies së një sendi në vetvete. Por, në rastin e përgjegjësive juridike e morale termi *shkak* përdoret për të zbuluar një ose disa shtysa që gjenden në rrethanat e në motivet e qenies njerëzore. Në këtë mënyrë, veprimi njerëzor mund të përfshijë si veprimin të qëllimtë, dhe veprimin e kryer pa dashje. Ndërsa fjala *pasojë* përdoret kur mendohet se ka një lidhje në realitet midis shfaqjes së një dukurie dhe disa të tjerave pas saj.

Nevoja për të shpjeguar motivet e sjelljes njerëzore, në raste të tilla kushtëzohet nga fakti se, nga shkalla e kësaj përgjegjësie vendoset edhe niveli i saj i trajtuar ose jo me ligj. Në këtë mënyrë, një njeri quhet i përgjegjshëm, në qoftë se ai, i gjendur përballë disa rrethanave, merr vendim në mënyrë racionale, duke parashikuar ndikimin që do të ketë veprimi i tij mbi atë dhe mbi të tjerët mbi bazën e ligjit. Pra, për çdo vendim konkret që merret për të vepruar, ai duhet të mbajë parasysh përligjjen që duhet t’i bëjë veprimit të tij jo vetëm në sytë e të tjerëve, siç ngjet me moralin, por edhe para ligjit.

Një parakusht kryesor në përcaktimin e përgjegjësive përbën *vullneti i lirë*. Prandaj edhe Bentami pohon se dënimi duhet të binte vetëm mbi persona që kanë vepruar me vullnet të lirë. Vullneti i lirë nënkupton që njeriu është i varur prej vetvetes për zgjedhjet e tij. Themi se kemi të bëjmë me zgjedhje të lirë kur: Personi ka mundësi të zgjedhë. Kur ajo që zgjedh përkon me synimet e tij për të mirën mendore ose materiale, dhe kur ai vendos vetë për këtë zgjedhje.

Disa raste kur vihet në pikëpyetje ky vullnet i lirë janë: Në qoftë se dikush vepron në kundërshtim me ligjin, duke u gjendur nën kërcënimin e dikujt. Ose, në qoftë se shoqëria ia heq vullnetin e lirë njeriut dhe mandej e ndëshkon për veprimet që ai kryen. Rusoi te

¹ Alexy, Robert: *Theorie der juristischen Argumentation*, 2. Aufl., Suhrkamp Verlag, Frankfurt a. M., 1991, f.261.

“Kontrata sociale” e ka kapur më së miri këtë element kur thotë: “T’i heqësh çdo liri vullnetit të njeriut do të thotë t’ heqësh çdo moralitet veprimeve të tij,,² Domethënë, në rast se shoqëria rrit skllëvër, në kuptimin, që jetojnë ndër geto varfërie, me mungesa elementare për të jetuar, e pa i ofruar zgjedhje për të punuar, kjo shoqëri me institucionet e saj nuk mund ta ndëshkojnë një njeri të tillë të rritur me te keq që vjedh për të mbijetuar. Përderisa institucionet shoqërore i kanë hequr atij vullnetin e lirë për të zgjedhur, njëkohësisht i kanë hequr të drejtën vetvetes për ta ndëshkuar këtë person, si një individ që ka pasur zgjedhje të lirë, sepse personi në fjalë ka qenë i detyruar ose te vdesë ose të shkelë ligjin.

Ka edhe raste kur vetë ligji “cënon,, vullnetin e lirë, me mënyra të tilla veprimi si, internimi prej shtetit, ndëshkimi edhe i familjarëve, mbyllja në çmendinë, ose karantinat për sëmundje infektive. Në këto raste më flagrante të zhdukjes së vullnetit të lirë, *nuk mund t’i kërkosh më përgjegjësi qenies njerëzore*, nëse mund të quhet e tillë. Ndryshe prej Rusoit, Milli nuk i jep edhe aq peshë rrethanave shoqërore. Cilësia e vullnetit të lirë tek ai nënkupton se “vullneti ndryshe nga dukuritë e tjera nuk përcaktohet në masë të madhe nga e kaluara, por dikton vetveten,,³. Me këtë tezë Milli synon të tregojë se vullneti i lirë i njeriut, nuk është pasojë e drejtpërdrejtë e disa shkaqeve të jashtme, përderisa njerëz të ndryshëm veprojnë ndryshe *në rrethana të njëjta*. Kjo do të thotë se liria e vullnetit nënkupton edhe rastësinë e zgjedhjeve.

Rëndësia e vullnetit të lirë për shfajësimin e njerëzve theksohet edhe nga Hart, kur shkruan: “Pranimi i disa argumenteve për shfajësim si një kërkesë e drejtësisë, nënkupton se drejtësia qëndron në peshimin e mirë të pretendimeve konkurruese të individëve, duke i marrë seriozisht në masë të njëjtë këta individë, për sa kohë që paraqesin veprime me vullnet të lirë,,⁴. Kësisoj, Harti na nxit të dallojmë mirë një të dyshuar që paraqet një sjellje të synuar e të llogaritur mirë nga sjelljet që janë krijuar për shkak të teknikave manipuluese që mund të përdoren nga disa persona në kurriz të tjerëve. Një hallkë konceptesh që na paraqitet këtu e që kërkon qartësim, është dallimi ndërmjet qëllimeve dhe dëshirave njerëzore.

2. Qëllimi i vullnetshëm, dëshira e pavullnetshme

Një njeri mund të dëshirojë të vrasë dikë, por nuk e vret atë pasi kur e kalon idenë nëpër filtrat e arsyes, e kupton që nuk duhet ta bëjë këtë për shumë motive. Kështu që dëshira nuk kthehet në qëllim. Por, nga ana tjetër, një njeri mund të mos dëshirojë të vrasë dikë, e

² Ruso, Zhan-Zhak: *Kontrata Sociale*, Shtëpia Botuese Luarasi, Tiranë 1998, f. 21.

³ Mill, John Stuart: *Një sistem Logjike*, në *Utilitarizmi dhe shkrime të tjera*, Shtëpia botuese ISP&Dita 2000, f. 77

⁴ Hart, H.L.A: *Eine Vereinigungstheorie von Prävention und Vergeltung*, në *Recht und Moral*, Texte zur Rechtsphilosophie, Hrsg von N. Hoerster, Reclam Verlag, Stuttgart 2002, f. 277.

megjithatë e vret atë, si në rastet e aksidenteve automobilistike. Pikënisja e kësaj ideje gjendet te filozofët Spinoza e Hobs, të cilët dallojnë arsyetimin për një veprim nga veprimi për një arsye a qëllim. Këtë dallim të zbatuar në fushën e së drejtës, na sjell para syve mjaft qartë John Finnis, kur përshkruan doktrinën juridike angleze dhe ndryshimin ndërmjet *qëllimit* dhe *dëshirës*. Kjo diferencë u bë aty nga mesi i shekullit 20. Teoricienët ligjor pretendojnë se koncepti legal i qëllimshmërisë domethënë, “që të jenë parashikuar me qartësi pasojat këtij qëllimi”,⁵. Për ta qëllimi është diçka krejt e dallueshme prej motiveve dhe dëshirave. Konflikti zakonisht zhvillohet ndërmjet akademikëve të së drejtës dhe juristëve praktikë, për të cilët të synosh diçka është e njëjtë me të dëshirosh diçka.

Dëshira emocionale mund të jetë shumë më e shtrirë se qëllimi i vullnetshëm e kontrolluar nga arsyeja. Në kuptimin se mund të dëshirosh të shkosh në Mars, por nuk mundesh. Pra, dallimi që bën Finnis ndërmjet dëshirës dhe qëllimit është ndarja e dëshirës emocionale të pavullnetshme prej qëllimit të vullnetshëm. Të synosh diçka apo ta kesh ndër mend atë nuk është thjeshtë çështje ndjenjash e emocione, por çështje planifikimi për ta arritur. Mirëpo, faktorët racionalë në zgjedhje e synime nuk përjashtojnë aspak praninë e shqisave ose imagjinatës në zgjedhje, madje edhe të ndjenjave. Natyrisht se edhe kur duam të arrijmë ca qëllime të planifikuara ka ndjenja e emocione, *por këto nuk luajnë rol kryesor*.

3. Synimi dhe parashikimi i pasojave

Një dallim tjetër që duhet bërë kur analizojmë veprimet njerëzore, është ai ndërmjet diçkaje të *synuar* dhe *parashikimit*. Nuk mjafton të synosh disa qëllime të mira në dukje, kur mund të ketë pasoja anësore shkatërruese, si për shembull ndërhyrjet në fushën e kirurgjisë plastike në disa raste. Po kështu, parashikimi dhe qëllimi mund të jetë krejt të ndryshme gjatë përdorimit të drogës, domethënë, përdoruesi parashikon kënaqësi por nuk synon vdekjen e shpejtë, që mund të arrijë. Prandaj, edhe efektet anësore i nënshtrohen gjykimit moral e ligjor.

Në dallim prej juristëve legalë, që duan të lidhin qëllimshmërinë me aftësinë për të parashikuar sa më shumë pasoja, Finnis thotë: “ Fakti se një parashikim i qartë rezulton si më i pëlqyeshëm për t’u ndjekur nga veprimi, nuk do të thotë se personi e dëshiron këtë diçka të parashikuar.”⁶ Ky i fundit bëhet për një qëllim të mëtejshëm jo i zgjedhur me dëshirë nga vetë personi. (Për shembull të punosh si nxënës te një avokat meqë nuk kap dot mesataren e Magjistraturës). Ndoshta, ajo që duhet të mbajmë parasysh kur flasim për

⁵ Finnis, John: *Intention and side-effects, në Liability and Responsibility*, Essays in law and morals, Cambridge University Press 1991 f. 34-35.

⁶ Finnis, J:Po aty, f. 44.

aftësi parashikuese është një tezë e Hanah Arendit që thotë: “Kufizimet që imponon ligji (në veprimet njerëzore) nuk janë kurrë mbrojtëse të sigurta kundër të vepruarit..., ashtu si kufijtë tokësorë nuk janë kurrë mbrojtës krejt të sigurtë kundër veprimit nga jashtë... Paparashikueshmëria e veprimeve njerëzore vjen nga pamundësia për të parashikuar pasojat e një akti brenda një bashkësie të barabartësh, në të cilën gjithkush ka të njëjtën aftësi për të vepruar”⁷. Në këtë pikë na duhet të marrim parasysh edhe rolin e rastësive në veprimet njerëzore.

4. Pesha e rastësive

Ne jemi përgjegjës për disa pasoja të veprimit ose mosveprimit por jo për disa të tjera. Sipas Hartit: “Cilësia kryesore që duhet të çojë në zbutjen e dënimit, vjen nga krijimi i arsyeshëm i bindjes se për personin e akuzuar ishte shumë e vështirë të ndiqte kërkesat e ligjit, krahasuar me persona që gjenden në rrethana të tjera më normale për zbatimin e ligjit..”⁸ Ajo çka mund të rreshtohet ndër rrethanat jonormale mund të variojë qysh prej gjendjes shpirtërore të pazakontë e deri te një sërë rrethanash të pamundura për t’u parashikuar. Sipas Hartit kemi të bëjmë me rastësi kur: “Lidhja e dy ose më shumë dukurive në një kornizë të caktuar hapësinore dhe kohore është 1) me të vërtetë e pamundur sipas standardeve të zakonshme, 2) është për disa arsye domethënëse ose e rëndësishme, me kusht që 3) të ndodhë pa planifikimin e njeriut... Është njëllë sikur dy persona, duke jetuar në vende të ndryshme e në mënyrë të pavarur, të arrijnë të shkruajnë të njëjtin libër mbi të njëjtën temë..”⁹

Por kur veprimet janë të njëpasnjëshme e të rregulluara që më parë, këtu nuk kemi të bëjmë më me rastësi. Këtu nuk duhet parë vetëm se si ka vepruar njeriu, por më tepër *se si ka zgjedhur ai të veprojë*. Njohja e qëllimeve të individëve ose e grupeve ku ata përfshihen është elementi kryesor për përcaktimin e shkaqeve dhe e përgjegjësive në këtë rast, sepse besnikëria dhe solidariteti me grupin mund të shpjegojnë shumë veprime të tyre, që në fillim na duken rastësore. Domethënë, prapa “rastësive” mund të fshihen shumë lidhje të domosdoshme shkak-pasojë, por të panjohura për ne. John Finnis, thotë: “Mund të ekzistojë një paqartësi dhe dyshim i mirëfilltë, për atë që mund të quhet një veprim i synuar dhe çfarë ka qenë një efekt i paparashikuar ose anësor i një veprimi. ...Po kështu, shpesh nuk arrihet të dallohet se çfarë i përket zgjedhjes së lirë dhe ku ndryshon kjo prej spontanitetit, lirshmërisë në të vepruar”.¹⁰

⁷ Arendt, Hannah: *Gjendja njerëzore*, Shtëpia botuese Ipl&Dita 2000, Tiranë 2006, f. 243, 304.

⁸ Hart, H.L.A: *Eine Verainigungstheorie...*f. 272

⁹ Hart , H.L.A. & Honoré, Tony: *Causation and Responsibility*, në *Philosophy of Law* Fourth Edition, Wadsworth Publishing Company, Belmont California, 1991, f. 510.

¹⁰ Finnis, John:Po aty f. 32

Kjo duket mjaft qartë sa hyjmë në fushën e bioetikës. Për të përcaktuar shkaqet dhe pasojat e një vdekjeje të papritur, duhet parë nëse me ndërhyrjen e tij mjeku ka respektuar autonominë e pacientit. Kjo autonomi ka të bëjë me faktin, që atij duhet t'i cënohet sa më pak liria e tij dhe t'i shkaktohen sa me pak vuajtje A ka synuar ai të shmangë dëmtimet e mundshme sa më shumë gjatë ndërhyrjes së tij? Dhe më së fundi, por jo për nga rëndësia, a e ka trajtuar me kujdes e në kohën e duhur pacientin? Mirëpo për pacientët, për të cilët duhet një ndërhyrje e shpejtë shpëtuese nuk mund të përmbushen disa elementë të tillë dhe kjo zvogëlon barrën e përgjegjësisë të mjekut. Atëherë, një zinxhir rastësish që përsëriten brenda së njëjtës ngjarje nuk mund të quhen më thjeshtë rastësi. Për shembull, kur në veprimin e mjekut nuk tregohet asnjë prirje për të vepruar sipas këtyre rregullave. Një zinxhir rastësish nuk mund të përligjë ato veprimeve që duhet të bëheshin mbi bazën e domosdoshmërisë. Duket se mjeku i ka dhënë hapësirë shumë “rastësive” me moskompetencën e tij.

5. Përgjegjësia dhe faktori kohë

Një pjesë e përgjegjësisë kushtëzohen pa tjetër edhe nga koha: Sa mund të quhet “shkak” për veprimin një akt ose motiv paraardhës në kohë? Një pyetje e tillë të lind vetvetiu kur ne e dimë se pasojat e veprimeve njerëzore mund të mos jenë të menjëhershme por mund të shtrihen për një kohë të gjatë, si për shembull zhdukja e specieve të bimëve dhe të kafshëve, ndotja e mjedisit etj., ku brezat e ardhshëm duket se varen shumë nga pasojat e veprimeve tona. Prej kësaj vjen ai element që Hans Jonas e quan “detyrim për zgjerimin e dijeve” domethënë, “të arrihet dija më e mirë e mundshme për veprimin dhe pasojat e tij në një kohë sa më të gjatë.”¹¹ Kjo nënkupton në epistemologji që, në rast se njeriu për të vepruar drejtë duhet të njohë pasojat e ardhshme të veprimeve të tij, *dija bëhet një detyrim mëse i përligjur* për të kërkuar mandej përgjegjësinë. Dhe kjo dije nuk është për çdo gjë e për gjithçka, por vetëm të mundësojë njohjen e përmasave shkakësore të veprimeve tona. Mirëpo, numri i shkaqeve të një dukurie mund të jetë shumë i madh. Madje, kontrolli i shkaqeve dhe përfytyrimi i pasojave në atë mënyrë që na e ofron për shembull dija teknike, mund të zbulojë gjithnjë shkaqe të reja e të panjohura më parë.

Hans Jonas na shtyn të besojmë se kur njohim motivet dhe rrethanat kryesore që e shtyjnë një person drejt një veprimi, duke njohur gjithashtu dhe karakterin e prirjet e tij, mund të parashikojmë se si do të veprojë ai. Ndonëse, siç u tha më sipër, ne nuk mund t'i njohim me siguri të plotë këto elementë, sepse secili prej nesh ka një hapësirë lirie në veprim e zgjedhje. Kështu që, na duhet të pranojmë me Anthony Kenny-n që: “Termi *përgjegjësi mendore* është një term i çuditshëm... Pyetja nëse duhet shpallur fajtor një individ, duhet të jetë një pyetje që nuk duhet t'i përgjigjet psikiatri por juria; Po kështu pyetja nëse duhet të dënohet një person nuk është çështje e psikiatrit por e organit ligjvënës. Mirëpo,

¹¹ Jonas, Hans: *Philosophische Untersuchungen und Metaphysische Vermutungen*, Fischer Verlag, Frankfurt a.Main, 1999, s. 120.

një psikiatër, të cilit mund t'i kërkohet të japë dëshmi mbrojtëse, nëse duhet pakësuar përgjegjësia e personit, mund të japë më tepër opinionin e tij në lidhje me këtë çështje”¹² Pikërisht për të shmangur një ndikim të tillë të fuqishëm opinionesh në çështjet ligjore do të ishte e nevojshme që juria, ose gjykatësi të ecin më me lirshmëri në atë që quhet kapacitet për të njohur e parashikuar pasojat e veprimeve nga njerëz të caktuar.

Si përfundim, disa rregulla që mund të na japë një interpretim filozofik i përgjegjësive në të drejtën janë:

1. Identifikimi i veprimit kryesor dhe i shkallës së vullnetit të lirë;
2. Vlerësimi i qëllimshmërisë sipas një shkalle në çdo hallkë të veprimit. Kjo domethënë se sjellja e një njeriu të veçantë peshohet sipas mënyrës së veprimit në atë sistem veprimesh të cilit ai i përket në mënyrë të përgjegjshme (sport, familje, punë etj.);
3. Njohja e pasojave dhe peshimi se sa janë parashikuar ato;
4. Zbulimi i rolit të rastësive në veprimin kryesor;
5. Rivlerësimi i pasojave mbi bazën e faktorit kohë (si për shembull në ndërhyrjen ndaj mjedisit, ose të mjekut);
6. Krahasimi i përfundimeve të dala në këtë rrugë me kriteret e përligjjes dhe ndëshkimit në ligj.

¹² Kenny, Anthony: *Can Responsibility be diminished?* Në *Liability and Responsibility*, Essays in law and morals, Cambridge University Press 1991, f. 20.

Bibliografi

Alexy, Robert: *Theorie der juristischen Argumentation*, 2. Aufl., Suhrkamp Verlag, Frankfurt a. M, 1991.

Arendt, Hannah: *Gjendja njerëzore*, Shtëpia botuese Ipls&Dita 2000, Tiranë 2006.

Finnis, John: *Intention and side-effects, në Liability and Responsibility*, Essays in law and morals, Cambridge University Press 1991.

Hart, H.L.A: *Eine Vereinigungstheorie von Prävention und Vergeltung, në Recht und Moral*, Texte zur Rechtsphilosophie, Hrsg von N. Hoerster, Reclam Verlag, Stuttgart 2002.

Hart , H.L.A. & Honoré, Tony: *Causation and Responsibility, në Philosophy of Law* Fourth Edition, Wadsworth Publishing Company, Belmont California, 1991.

Jonas, Hans: *Philosophische Untersuchungen und Metaphysische Vermutungen*, Fischer Verlag, Frankfurt a.Main, 1999.

Kenny, Anthony: *Can Responsibility be diminished? Në Liability and Responsibility*, Essays in law and morals, Cambridge University Press 1991.

Mill, John Stuart: *Një sistem Logjike, në Utilitarizmi dhe shkrime të tjera*, Shtëpia botuese ISP&Dita 2000.

Ruso, Zhan-Zhak: *Kontrata Sociale*, Shtëpia Botuese “Luarasi,, Tiranë 1998.